

**Data: 06.07.2023**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: FV IMPIANT I RI 0.4KV I NEVOJAVE VETJAKE TE PERGJITHSHME TË CENTRALIT, ME DY HYRJE 3200A DHE SEKSIONATOR ME AUTOMATIKE CHANGE-OVER E MBROJTJE TERMOMAGNETIKE, DALJE ME KONTROLL MANUAL 400A DHE 800/1000A, PAJISUR ME MBROJTJE TERMOMAGNETIKE**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 65,000,000 (Gjashtëdhjetë e pesë milion) Lek pa TVSH 621,712 (Gjashtëqind e njëzet e njëmijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 06 /07/2023 është 104.55 Lekë/Euro***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit..

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose distributor i autorizuar për pajisjet që do të ofrojë.

*Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.3.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe

*procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

NS 14/A Impiante te brendshme, elektrik, telef, radiotelefo Tv,

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).*

**Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikimi.**

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 germa c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pika e licencës e kërkuar në këtë kriter lidhet ngushtë me kërkesat sipas specifikimeve teknike ku kërkohet jo vetëm furnizimi i impiantit por edhe demontimi i impiantit ekzistues dhe montimi i impiantit të ri pa ndryshuar skemën e furnizimit të nevojave vetjake të përgjithshme të HEC Koman.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik në licensën e tij minimum 1(një) Inxhinier Elektrik dhe 1(një) Inxhinier Mekanik.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diploma
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Prill 2023 – Qershor 2023

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të këtë në stafin e tij:

- Minimumi 1(një) Inxhinier Elektrik të çertifikuar nga prodhuesi/ institucione të autorizuar për impiante shpërndarës në TU.
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektrik, të çertifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuar për mbrojtjet rele dhe komandimeve.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë**

**pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Çertifikatat e mësipërme të vlefshme,
- Diploma
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Prill 2023 – Qershor 2023

**Shënim: AK do të lejoj që 1(një) Inxhinier të ketë më shumë se një Certifikim. Gjithashtu Inxhinieret e kërkuar në kriteret 2.3.4 dhe 2.3.5 mund të jenë pjesë e licensës së shoqërisë.**

**Argumentimi:** Për sa i takon kriteret **2.3.4** dhe **2.3.5**, kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e mësipërm lidhen ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar, i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure. Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik 1(një) Inxhinier Elektrik dhe 1(një) Inxhinier mekanik në licensën e tij lidhen ngushtë me objektin e prokurimit, kjo për të bërë të mundur zbatimin e kontratës që nga furnizimi i impiantit në përputhje me specifikimet teknike, përgatitjen e vizatimeve dhe montimin e tij. Impianti shpërndares 0.4 kV është i përbërë nga komponentë elektrike dhe mekanike. Assemblimi i të gjithë elemente të impiantit, do të realizohet në një strukturë metalike, shumë kompakte që duhet të përmbush të gjitha kërkesat për qëndrueshmëri mekanike dhe elektrike. Gjatë instalimit të impiantit do të realizohen punime elektrike për lidhjet e kablllove të fuqisë, lidhjeve të brendshme dhe të jashtme të kablllove të kontrollit, dhe gjithashtu punime mekanike për montimin dhe fiksimin e të gjitha pjesëve të panelit, sipas standarteve.

Sa më sipër, për tu siguruar që OE do të ketë kapacitet teknike për të gjithë natyrën e punimeve që do të kryhen, duhet të jetë i licensuar për punime të instalimit të impanteve të brendshme elektrike dhe të ketë në stafin e tij minimum një Inxhinier Elektrik dhe një Inxhinier Mekanik.

Gjithashtu kërkesat që Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar Inxhinier Elektrik të çertifikuar për impiante shpërndarës në TU dhe të çertifikuar për mbrojtjet rele dhe komandimet, janë nevojë specifike për instalimin dhe konfigurimin, përshtatjen me sukses të impiantit të ri. Impiantet shpërndarës TU të përmasave të tilla ku kemi rryma të rendit 3200A, me dy seksione zbarash dhe ku janë tre burime të pavaruara që komutohen me çelësa automatike me llogjikë interlokimi për change over, janë shumë specifike për sa i përket instalimit dhe testimit të tij. Për rryma kaq të mëdha fenomenet që ndodhin ( efekti termik ,forcat elektrodinamike për lidhje të shkurtra, interferencë elektromagnetike) sjellin kërkesa të larta teknike që duhet të zbatohen gjatë instalimit. Sa më sipër OE duhet të garantojë që punimet do të realizohen duke plotësuar të gjitha standartet dhe kushtet teknike që prodhuesi referohet.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë çertifikata / deklaratë se prodhimi i panelet shpërndarës TU, do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe direktivave të Bashkimit Europian ose ekuivalente, si më poshtë:

- IEC61439, (Asemblimi i Impianteve shpërndarës TU),
- IEC60068, (Provat ndaj ndikimeve ambientale për Impiantet shpërndarës TU),
- IEC60947, (Standarti i testimit të Çelësve për Impiantet shpërndarës TU),

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur referuar nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar standartet e prodhimit të paneleve shpërndarës TU, pjesë kryesore e impinateve të kërkuar.

-IEC61439 (Asemblimi i impianteve shpërndarës TU).

Për prodhimin e një impianti shpërndarës të permasave të tilla, duhet të llogariten efektet termike në të gjitha kontaktet dhe bashkimet elektrike, qëndrueshmëria elektro-dinamike për regjim të lidhjes së shkurtër dhe impakti nga vibrimet ambientale. Sa më sipër të gjithë komponentet përbërës të impiantit duke filluar që nga aksesorët që shërbejnë për bashkimet elektrike, dhe elementët shtrëngues të zbarave duhet të montohen brenda kushteve teknike që kërkohen nga standarti IEC ose ekuivalent.

-IEC60068 (Provat ndaj ndikimeve ambientale)

Vend instalimi i impiantit 0.4kV do të jetë në sallën e makinerive në HEC Koman, ambient i cili është gjithmonë nën veprimin e vibrimeve me frekuencë të njëjtë dhe amplitudë të vogël. Vibrimet mund sjellin sforcime të elementeve shtrëngues, duke shkaktuar krisje apo edhe lirim të bullonave. Nën këto kushte, është kërkuar në specifikime që impianti 0.4kV të testohet sipas standartit IEC60068, në mënyrë që të garantohet që asnjë element mos të impaktohet nga vibrimet, pasi në rast të rritjes së rezistencës së kontaktit nga lëvizja e bashkimeve të zbarave do të kishim pasoja të pakthyeshme nga efektet termike që ndodhin.

-IEC60947 (Standarti i testimit të çelësve për impiantet shpërndarës TU)

Çelësat automat 0.4kV, me dhomë harkshuese me ajër duhet të plotësojnë disa parametra shumë të rëndësishëm, që kanë të bëjnë me aftësinë ç’kyçese të rrymave nominale dhe rrymave për regjim të lidhjes së shkurtër. Çelësat automat duhet të përballojnë rrymat e lidhjes së shkurtër deri në limitet e kohës që përcakton standarti IEC në mënyrë që mos të rrezikohet për tu kthyer në burim zjarri.

Për të vërtetuar që çelësat i plotësojnë parametrat si më sipër, prodhuesi duhet të paraqesë një çertifikatë ose dokument testimi, që të vërtetojë që çelësat do të nënshtrohen të gjitha testeve tip të përcaktuar në standart.

Prodhuesi që do të prodhojë impiantin 0.4kV duhet të deshmojë që është i certifikuar sipas standarteve IEC61439, IEC60068, IEC60947 ose ekuivalent.

**2.3.7** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën që vërteton se sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit/ve të jetë sipas standartit ISO 9001:2015 e përshtatshme për objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** - Ky standard është i nevojshëm për vërtetuar se prodhuesi është i certifikuar në standardet dhe sistemet e menaxhimit të cilësisë duke përfshirë një fokus të fortë ndaj klientit, motivimin dhe implikimin e menaxhmentit të lartë, qasjen e procesit dhe përmirësimin e vazhdueshëm

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”
- ISO 50001-2018 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”

**ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**ISO 50001-2018 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”** – Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në ëbsite të tyre përkatës.

**Argumentimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.3.10** Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë test raport / deklaratë nga prodhuesi mbi testimet që kryhen për impiantet shpërndarës TU.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur referuar nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar testimet që do ti bëhen impiantit të kërkuar.

*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

*Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Impianti shpërndarës 0.4kV i nevojave të përgjithshme në HEC Koman furnizon nevojat vetjake të agregateve dhe të gjithë konsumatorët 0.4kV në godinën e centralit. Që në kohën e ndërtimit të centralit ky impiant është lloagritur që të përballojë të gjithë konsumatorët dhe është llogaritur edhe rezervë për prespektivën. Në specifikimet teknike që janë hartuar, është ruajtur i njëjti konfigurim ë skemës primare, dhe është ruajtur i njëjti përmasim i rrymave nominale. Në lidhje me standartet e sotme të prodhimit të këtyre impianteve, është kërkuar që impianti dhe çelesat 0.4kV të jenë konform standarteve IEC si praktika më e mirë në lidhje më kërkesat që duhet të plotësohen.

Për të përmirësuar saktësinë e veprimit të automateve dhe për të siguruar selektivitet në raste të lidhjeve të shkurtra, automatet kryesore të furnizimit dhe seksionuesi janë kërkuar me rele elektronike të tarueshme.

## **Njësia e Prokurimit**